

Udhëzime për Përgatitjen e Historisë Vjetore për Kunjin, Distriktin, Lagjen ose Degën

Qëllimi

Përgatitja dhe paraqitja e një historie vjetore ndihmon në përmbushjen e detyrës së Zotit: “Të vazhdoj[më] të shkruaj[më] dhe të bëj[më] një histori të gjithë gjërave të rëndësishme . . . lidhur me kishën [e Tij]. . . . Dhe gjithashtu, shërbëtorët e [Tij] që janë përhapur në botë, duhet t’i dërgojnë tregimet e kujdestarive të tyre” (DeB 69:3, 5).

Vështrim i Përgjithshëm

Përpilimi i historisë vjetore duhet të fillojë në janar dhe duhet të vazhdojë përgjatë gjithë vitit. Çdo lagje duhet të krijojë historinë e saj dhe ta paraqesë në kunj. Kunji i ndërthur historitë e lagjeve me raportin e tij dhe dorëzon një histori të vetme vjetore të Kishës. Degët dhe distriktet ndjekin po të njëjtin model.

Udhëheqësit e priftërisë fillojnë duke ia caktuar përgjegjësinë për përpilimin e historisë nëpunësit të lagjes ose kunjit, ndihmësnëpunësit ose një specialisti historie që punon nën drejtimin e nëpunësit. Personi i caktuar duhet të mbledhë materiale gjatë gjithë vitit dhe duhet t’i ftojë të tjerët të kontribuojnë me histori dhe informacion.

Çfarë Duhet të Përfshihet

Ka dy variante për përpilimin e historisë vjetore: historia bazë ose historia gjithëpërmbledhëse. Udhëheqësi i priftërisë, duke marrë parasysh rrethanat e njësisë së tij të Kishës, do të përcaktojë se cilin variant të ndjekë.

Një histori bazë vjetore duhet të përmbajë:

1. Kopertinën.
2. Një tregim të shkurtër që përshkruan ngjarje dhe zhvillime të rëndësishme të vitit. Përfshin histori për ndërtimin e besimit.
3. Kalendarin e njësisë.
4. Formularët për Nënpunësit e Mbështetur, të lexuara në konferencat e lagjeve dhe kunjeve.

Përveç katër çështjeve të lartpërmendura, një histori gjithëpërmbledhëse përmban:

5. Raporte nga udhëheqësit e priftërisë dhe të organizatave ndihmëse që përmbledhin përpjekjet

e tyre për të ndihmuar individët dhe familjet që të kualifikohen për ekzaltimin. Për shembull, një peshkop mund të përcaktojë disa synime për lagjen në fillim të vitit dhe më pas të ftojë këshillin e lagjes të kontribuojë me histori dhe fotografi, duke dhënë detaje për mënyrën se si ka punuar çdo organizatë për t’i arritur këto synime.

6. Raporte kuptimplote të krijuara nga ose rreth njësisë, të tilla si:

- Fotografi që identifikohen dhe datohen qartë.
- Buletine informative.
- Programe dhe botime të veçanta.
- Fotokopje të pjesëve të shkëputura nga gazeta (përfshirë informacion që do ta identifikojë gazetën dhe datën që është botuar).

Vini re se informacioni i fshehtë ose vetjak *nuk* përfshihet në asnjë mënyrë në historinë vjetore.

Paraqitja

Historitë e lagjeve dhe degëve dorëzohen në kunj ose distrikt jo më vonë se 1 marsi. Historitë e kunjeve dhe distrikteve dorëzohen në Seksionin për Historinë e Kishës ose në zyrën e caktuar të administrimit jo më vonë se 31 marsi. Kopjet e historisë mund të ruhen në shkallë vendore.

Kunjet dhe distriktet në Shtetet e Bashkuara dhe Kanada duhet ta dërgojnë me postë versionin origjinal të historisë vjetore në:

CHURCH HISTORY DEPARTMENT
ANNUAL HISTORY
15 EAST NORTH TEMPLE STREET
SALT LAKE CITY, UT 84150-1600

Njësitë jashtë Shteteve të Bashkuara dhe Kanadasë duhet t’i dërgojnë me postë historitë e tyre te zyra e caktuar e administrimit.

Për informacion shtesë, për kopertinën dhe modellet, shih *Church History Guides: Stake, District, and Mission Annual Histories* [Udhëzime për Historinë e Kishës: *Historitë Vjetore të Kunjeve, Distrikteve dhe Misioneve*] ose vizitoni [lds.org/annualhistories](https://www.lds.org/annualhistories).